



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1042/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevcu dhe Rustem Thaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Fahri Sheqiri kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Prishtinës, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prishtinës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1042/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Fahri Sheqiri kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Prishtinës, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në qendrën e votimit 1956E.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1044/2021 të paraqitur nga Fahri Sheqiri kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Prishtinës, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me të cilën ndër të tjera pretendon se në qendrën e votimit 1956E, një qytetar së bashku me bashkëshorten e tij kanë votuar dhe se votat e tyre nuk janë evidentuar, dhe kërkon nga PZAP që ta evitoj këtë parregullsi.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i paraqitur nga Fahri Sheqiri kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Prishtinës, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimin e lartcekura, është i pa bazuar. Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta si deklarata e deshmitarve dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur. Edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apellesit nuk janë

mbështetur në prova dhe fakte konkret, deklarata apo ndonjë formular, por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.1042/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.